



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO  
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO



Pranimi / Dorezimi Prinyem / Prilazje Received / Deliverty	01.12.2021	viti god year
Organ / Shkronja Organ / Jedinita Org / Unit	5762/2021	Sasia Kohëzina Quantity
SHKRONJA	5762/2021	1/14

## Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.857/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin e ankesave në përbërje nga: Arben Mehmeti-kryetar, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Eshref Shabani-anëtarë, si dhe Sabile Avdyli, Zyrtare e Lartë për bashkëpunim Profesional- në cilësi të procesmbajtëses, kanë shqyrtuar ankesën me numër protokollit 4965/2021 të datës 08.10.2021 të parashtruar nga ankuesi me adresë banimi rr” Zekerija Cana ” Mati I Prishtinë, kundër organit të punësimit-Agjencia e Shërbimit të Navigacionit Ajror, në çështjen juridike “kontestim konkursi”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nënparagrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nënparagrafin 1.8 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 01.12.2021, mori këtë:

### V E N D I M

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Shpallet jo kompetent për të vendosur për ankesën me numër A.nr.857/2021 të datës 08.10.2021 të parashtruar nga ankuesi

### A r s y e t i m

Ankuesi aplikues në pozitën: “ Drejtor/esh i Agjencionit të Shërbimit të Navigacionit Ajror” në konkursin e shpallur me datën 16.07.2021 nga Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës. Me datën 08.09.2021 Qeveria e Republikës së Kosovës nxjerr vendimin me nr.23/34 për emërimin e z. në pozitën Drejtor/esh i Agjencionit të Shërbimeve të Navigimit Ajror.

Ankuesi i pakënaqur me vendimin e datës 08.09.2021 me nr.23/34 të Qeverisë së Republikës së Kosovës për emërimin e z. në pozitën Drejtor/esh i Agjencionit të Shërbimit të Navigacionit Ajror, me datë 08.10.2021 ka parashtruar ankesën me numër protokollit 4865/2020 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 14.10.2021, ankesën e ankuesit e ka proceduar për përgjigje në ankesë tek Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës.Këshilli me datë 19.10.2021 ka pranuar dokumentacionin e bashkangjitur nga Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, lidhur me ankesën e ankuesit bashkë me shkresat e lëndës faqe 1/155.



Kolegji për shqyrtimin e ankesave për marrjen e vendimit meritore ka administruar këto prova: Ankesën e datës 08.10.2021 me numër protokoll 4965/2021 e parashtruar nga ankuesi përmes e-mailit në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; E-mail zyrtar i datës 23.09.2021; Njoftim për kandidatët fitues; Kopja e konkursit i datës 16.07.2021; Vendimi me nr.23/34 i datës 08.09.2021 për emërimin e Drejtorit të Agjencisë së Navigacionit Ajror; Vendimi i datës 10.08.2021 me nr.protokoll 3108/21 për themelimin e Komisionit për vlerësimin e kandidatëve; Formularët e vlerësimit për pozitën Drejtor i Agjencisë së Shërbimeve të Navigacionit Ajror; Regjistri i aplikacioneve të pranuar prej datës 16.07.2021 deri më datën 30.07.2021; Formulari për krijimin e listës së ngushtë; Përcaktimi i kriterëve për testimin me shkrim dhe me gojë për vendin e punës për të cilin kërkohet njohja e ndonjë gjuhe të huaj; Përcaktimi i kriterëve për përfshirjen në listën e ngushtë me datën 11.08.2021; Rezultatet përfundimtare të kandidatëve për pozitën Drejtor/esh i Agjencionit të Shërbimeve të Navigacionit Ajror; Njoftim për kandidatët fitues; Kërkesa për punësim e datës 29.07.2021 për bashkë me dokumentacionin e kërkuar; Diploma e datës 12.05.2008 nr.1917 e lëshuar nga fakulteti ekonomik në Universitetin e Prishtinës; Çertifikatë e datës 09.04.2018; Çertifikatë e datës 15.05.2017; Çertifikatë e datës 03.06.2013; Çertifikatë e datës 19.08.2013; Çertifikatë e datës 12.08.2013; Çertifikatë e datës 09.09.2013; Diploma e shtatorit e vitit 2013; Informatë mbi studentin i datës 07.05.2008; Çertifikatë për kualifikimin e e nga shoqata e kontabilistëve të certifikuar dhe Auditorëve të Kosovës; Dëshmi e muajit qershor 2007 se ka përfunduar të gjitha provimet e parapara me Rregulloren Nr.2001/30; vërtetim me të cilin dëshmohet se z. caktohet në detyrë Shef i Sektorit të Menaxhimit dhe Resurseve; Çertifikatë e datës 14.04.2021; Çertifikatë e datës 06.06.2019; CV e Vendimi i datës 29.06.2016 me nr.06/98 i Qeverisë së Republikës së Kosovës; Vendim i datës 30.12.2015 me nr.053/2015 i Bordit të drejtorëve të Aeroportit Ndërkombëtar të Prishtinës; Vendimi i datës 17.01.2013 me nr.004/2013; Kontrat punësimi e datës 17.01.2013 me nr.003/2013; Dëshmi e datës 04.04.2011 për emërimin e u.d Kryeshef Ekzekutiv i ANP; Aneks i marrëveshjes së punësimit i datës 04.04.2011; Aneks i marrëveshjes së punësimit i datës 31.12.2011; Kontratë punësimi prej datës 01.10.2008 deri 30.09.2009; Njoftim për vend të lirë të punës i datës 08.08.2008; Vërtetim i datës 18.02.2011 i lëshuar nga MPMS; Vërtetim i datës 28.01.2015; Testi me shkrim për kandidatët për Drejtor në ASHNA i datës 23.08.2021 për Kërkesa për punësim e datës 26.07.2021 për bashkë me dokumentacionin e kërkuar: Diploma e datës 25.01.2011 me nr.1688 e lëshuar nga Fakulteti Ekonomik në Universitetin e Prishtinës; Çertifikatë e datës 05.04.2002; Diploma e datës 31.01.2008; Diploma e datës 23.05.2008; Diploma e datës 22.10.2010; Diploma e datës 19.11.2012; Diploma e datës 09.01.2013; Çertifikatë e datës 04.11.2019; Çertifikatë e datës 26.08.2019; Çertifikatë e datës 09.09.2019; Çertifikatë e datës 30.09.2014; Çertifikatë e datës 26.10.2018; Çertifikatë e muajit mars 1999; Çertifikatë e datës 18.06.2019; Çertifikatë e datës 01.08.2003; Çertifikatë e datës 31.10.2014; Çertifikatë e datës 29.09.2005; Çertifikatë e datës 10.05.2006; Çertifikatë e datës 10.06.2006; Çertifikatë e datës 20.08.2000; Çertifikatë e datës 30.03.2004; Çertifikatë e datës e muajit prill 2017; Çertifikatë e datës 31.03.2017; Çertifikatë e datës 20.10.2005; Çertifikatë e muajit janar 2003; Çertifikatë e datës e muajit nëntor 2002; Çertifikatë e datës e datës 15.05.2017; Çertifikatë e datës 19.11.2004; Çertifikatë e datës 13.12.2017; Çertifikatë e datës e datës 13.01.2012; Çertifikatë e datës 01.09.2005; Çertifikatë e datës 11.04.2019; Çertifikatë e datës 20.06.2003; Çertifikatë e datës 23.01.2004; Çertifikatë e datës e datës 13.04.2018; Çertifikatë e datës 23.06.2019; Çertifikatë e datës 26.10.2018; Çertifikatë e datës 28.06.2019; Çertifikatë e datës 20.05.2019; Trajnim i datës 21.10.2020; Çertifikatë e datës 21.10.2020; Çertifikatë e datës 12.08.2020; Çertifikatë e muajit prill 2018 ; Aneks i marrëveshjes së punësimiti datës 01.05.2009; Vendim i datës 07.02.2018; Vendimi i datës 20.04.2018; Akt emërimi i datës 23.04.2018 me nr.0270; Përshkrimi i vendit të punës i datës 20.04.2018; Vërtetim i datës 26.07.2021 i lëshuar nga Policia e Kosovës; Kontratë pune për kohë të pacaktuar e datës 27.05.2014; Kopja e testit me shkrim për kandidatët për Drejtor/esh në ASHNA i datës 23.08.2021 për dhe Përgjigje në ankesë nga organi i punësimit e datës 19.10.2021 bashkë me shkresat e lëndës faqe 1/155.





Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave për vendosjen e kësaj çështje, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët, ka konstatuar se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil i Kosovës, *nuk është kompetent* për të vendosur për ankesën e parashtruar nga ankuesi *sepse:*

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, duke i 'u referuar dëshmime të ofruara nga ankuesi dhe organi i punësimit, konstaton se pozita e " Drejtor/esh i Agjencionit të Shërbimeve të Navigacionit Ajror" në konkursin e shpallur me datën 16.07.2021 nga Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës nuk është pozitë e e nëpunësit civil por nëpunës i shërbimeve publike. Këshilli me datën 19.11.2021 ka bërë kërkesë në Departamentin për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik lidhur me statusin e të punësuarëve të Agjencisë së Shërbimeve të Navigacionit Ajror, po me këtë datë kemi pranuar përgjigjen nga DMZP-ja se me datë 02.03.2021 i kanë dërguar pozitën e punës në Agjencinë e Shërbimeve të Navigacionit Ajror me që rastë kanë bërë përcaktimin e statusit të të punësuarëve në këtë institucion e që është përcaktuar si status i nëpunësit të shërbimeve publike duke përfshi edhe statusin e Drejtorit të Agjencisë së Shërbimeve të Navigacionit Ajror e që në këtë rast është në cilësin e ankuesit.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, mbi këtë bazë dhe duke ju referuar dispozitave të nenit 6 paragrafit 1 nën paragrafit 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil i Kosovës, nuk është kompetent për të vendosur për ankesën e parashtruar nga ankuesi, sepse Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil i Kosovës shqyrton dhe merr vendime për ankesat e nëpunësve civil dhe kandidatëve për praninë në shërbimin civil, në këtë rast ankuesi nuk është nëpunës civil. Poashtu edhe bazuar në dispozitat e nenit 6, paragrafi 6 i Ligjit Nr.04/L-250 për Agjencinë e Shërbimit të Navigacionit ajror përcaktohet se: *6. Nëse Drejtori beson se është larguar në mënyrë të paligjshme ai/ajo rastin mund t'ia drejtojë gjykatës kompetente.*

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, meqenëse ka konstatuar se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nuk është kompetent për të vendosur për ankesën e parashtruar nga ankuesi, atëherë udhëzon palën për ushtrimin e mjeteve juridike sipas nenit 24 paragrafit 4 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, i cili përcakton se: *"Nëpunësi i Shërbimit Publik dhe nëpunësi administrativ dhe mbështetës kanë të drejtë të ankohen sipas këtij ligji të punëdhënësi dhe më pas mund të fillojë kontest administrativ në gjykatën kompetente".*

Duke marrë parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe provat e bashkëngjitura në lëndë, Kolegji për shqyrtimin e ankesave, bazuar në nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.8 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë–Departamenti Administrativ, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.



Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës  
Lënda, A.nr.857/2021, datë 01.12.2021

Sabile AVDYLI

*Sabile Avdyli*  
Procesmbajtëse

Arben MEHMETI

*Arben Mehmeti*  
Kryetar i Kolegjit



*Vendimi i dërgohe*

*Ankuesit*

*Qeverisë së Republikës së Kosovës;*

*Ministrin të Ministrisë së Mjedisit Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës;*

*Udhëheqësit të Personelit në Ministrinë e Mjedisit Planifikimit dhe Infrastrukturës;*

*Arkivit të KPMSHCK-së*

